



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Rr "Abdi Toptani" ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel 04 22268142 ; 22268141

Nr. 18/3 Prot.

Tiranë, më 21.03.2017

V E N D I M

Nr. 56, datë 21/03/2017

"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimit të Komisionerit nr. 100, datë 13.09.2016"

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe nenin 34 e vijues të Rregullores, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr. 100, datë 13.09.2016 "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në institucionin Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave",

V ë r e j s e :

Për verifikimin e zbatimit të ligjit gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil, është zhvilluar një mbikëqyrje e përgjithshme pranë institucionit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, procedurë e përfunduar me Vendimin nr. 100, datë 13.09.2016, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në institucionin Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave".

Me kalimin e afatit 60 ditor të caktuar nga Komisioneri për zbatimin e rekomandimeve të vendimit të mësipërm, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit me shkresën nr.3771/1, dt.11.11.2016, ka informuar lidhur me veprimet administrative të kryera nga ky institucion, përmes të cilave pretendohet se janë zbatuar rekomandimet e Komisionerit, të cilat do të mundësonin vendosjen e

ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil. Bashkëlidhur informacionit është dërguar i gjithë dokumentacioni shkresor, me anën e të cilit materializohen procedurat e ndjekura.

Mirëpo, shkresa me nr. 3771/1, datë 11.11.2016, e dërguar nga institucioni i AKU, ishte e panënshtuar nga titullari i institucionit ose ndonjë person tjetër i autorizuar prej tij, dhe në këto kushte ky akt administrativ, bie ndesh me nenin 99/3, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, normë e cilat përcakton kërkesat formale që duhet të përmbajë një akt administrativ. Duke qenë se ky akt nuk i plotësonte kërkesat formale të cilat duhet të përmbajë një akt administrativ, në referencë të nenit 108/a/iii, të ligjit të sipërcituar, ky akt konstatohet absolutisht i pavlefshëm, dhe si i tillë nuk sjell asnjë pasojë juridike pasi konsiderohet se nuk ekziston.

Për këtë arsye, me Vendimin nr. 1, datë 13.01.2017, u vendos ngritja e një grupi pune, i cili u ngarkua të kryejë verifikimin e zbatimit të vendimit paralajmërues të Komisionerit nr. 100, datë 13.09.2016, duke shkuar në subjekt. Sipas parashikimeve të nenit 42 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me shkresën nr. 18/2 prot, datë 13.01.2017, është njoftuar institucioni lidhur me fillimin e procedurës për verifikimin në institucion të zbatimit të Vendimit nr. 100, datë 13.09.2016, si dhe ngritjen e një grupi i pune për këtë rast.

Pas administrimit të gjitha akteve administrative të cilat do të mundësonin një verifikim të plotë të veprimeve administrative të kryera nga Njësia Përgjegjëse për zbatimin e detyrave të ngarkuara nga Komisioneri, veprime të cilat do të vendosnin ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, u konstatua se detyrat janë realizuar si më poshtë vijon:

1. Mbi detyrën e lënë Njesisë Përgjegjëse, në pikën 2 të Vendimit nr. 100, datë 13.09.2016, për të ndryshuar aktet e deklaramit të statusit të punësimit, nga “*nëpunës civilë në periudhë prove*” në kategorinë “*nëpunës civil*”, për dy nëpunës civilë ***** dhe ***** , rezultoi se kjo detyrë është përmbushur. Nga ana e Departamentit të Administratës Publike, me cilësinë e Njesisë Përgjegjëse, është bërë rregullimi i deklaramit të statusit të punësimit për këta nëpunës.

✓ Përmes aktit nr. 5529/4 prot., datë 07.12.2016, është deklaruar punonjësja ***** , “*nëpunës civil*” në pozicionin *Inspektore në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë me Origjinë Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit*, në Drejtorinë Rajonale të AKU - Qarku Tiranë.

✓ Përmes aktit nr. 5529/5 prot., datë 07.12.2016, është deklaruar punonjësi ***** , “*nëpunës civil*” në pozicionin *Inspektor në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë me Origjinë Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit*, në Drejtorinë Rajonale të AKU - Qarku Vlorë.

2. Nga ana e Njesisë Përgjegjëse DAP, është realizuar detyra e lënë në pikën 3 të Vendimit nr. 100, datë 13.09.2016, pasi është nxjerrë akti nr.5529/6 prot., datë 07.12.2016, për deklarimin

e punonjësës *****”, “*nëpunës civil*”, në pozicionin e punës *Inspektore në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë me Origjinë Shtazore dhe Operatorëve të Biznesit* në Drejtorinë Rajonale të AKU - Qarku Tiranë, referuar nenit 67, pika 3, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”.

3. Mbi detyrën e lënë Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit, në pikën 4 të Vendimit nr. 100, datë 13.09.2016, për të përfunduar procesin e hartimit të përshkrimeve të punës, për të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, rezultoi se, kjo detyrë nuk është zbatuar. Pretendohej prej tyre sa janë duke punuar, por nuk ishte marrë asnjë masë konkrete për të ndjekur hapat e rekomanduara nga Komisioneri si më poshtë vijon:

- ✓ Të kërkojë zyrtarisht mendimin e Departamentit të Administratës Publike, për vlerësimin e ligjshmërisë së formularit të përshkrimit të punës për çdo pozicion pune në shërbimin civil, nëse është në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar.
- ✓ Pas marrjes së konfirmimit nga njësia përgjegjëse (DAP), të vijojë procesi me miratimin dhe nënshkrimin e përshkrimeve të punës, nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave , në ndarjen përkatëse, siç parashikohet në pikën 18, shkronja “c”, të Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, të ndryshuar.
- ✓ Pas miratimit, nënshkrimit dhe dokumentimit të përshkrimeve të punës, një kopje e tyre, të bëhej pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil dhe një kopje të depozitohej pranë Departamentit të Administratës Publike.

4. Mbi detyrën e lënë Njësia përgjegjëse (DAP) dhe Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit, në pikën 5 të Vendimit nr. 100, datë 13.09.2016, për revokimin e akteve administrative, për emërimet të përkohshme në detyrë, në disa pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të cilat kanë dalë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, dhe plotësimin e këtyre pozicioneve nëpërmjet një procedure të rregullt konkurrimi, rezulton se kjo detyrë është zbatuar si më poshtë:

- ✓ Është revokuar akti administrativ nr.50, datë 01.02.2016, për emërimin e nëpunësës *****”, në pozicionin “*Specialiste në Sektorin e Marrëdhënieve dhe Koordinimit Ndërinstitucional*”, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU. Mbas procedurave të konkurimit, kjo punonjëse është emëruar nga DAP në pozicionin e punës “*Specialiste e Sektorit Juridik në D.Sh.të Brendshme*”.
- ✓ Nuk është revokuar akti administrativ nr.73, datë 08.02.2016, për emërimin e nëpunësit *****”, në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Sistemit të Informimit të Shpejtë dhe Mbikëqyrjes së Tregut*”, në Drejtorinë e Vlerësimit dhe Komunikimit të Riskut, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU. Vështruar listëpagesës së muajit dhjetor 2016 ky

punonjës vazhdon të jetë në marrëdhënie pune. Për këtë pozicion pune janë kryer procedurat e konkurimit dhe është shpallur fituese *****. Mbas verifikimit të kryer pranë DAP rezultoi se akti i emërimit të fitueses është dërguar pranë institucionit, provuar ky fakt me librin e dorëzimit të postës, mirëpo titullari i institucionit refuzon ta zbatojë këtë akt.

- ✓ Nuk është revokuar akti administrativ nr.80, datë 12.02.2016, për emërimin e nëpunëses *****; në pozicionin “*Inspektore (Ushqimi) në Sektorin e Koordinimit të Inspektorëve në PIK*”, në Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU. Për këtë pozicion pune janë kryer procedurat e konkurimit dhe fituese është shpallur *****. Mbas verifikimit të kryer pranë DAP rezultoi se akti i emërimit të fitueses është dërguar pranë institucionit, provuar ky fakt me librin e dorëzimit të postës. Mirëpo, edhe për këtë rast titullari i institucionit refuzon të ekzekutojë aktin e emërimit nr. 750 datë 03.02.2017, duke lejuar vijimin e paligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, pasi akti i emërimit të Silvana Bejko është një akt i paligjshëm në kuptim të nenit 109 të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”. Pranë Komisionerit ka ardhur edhe një ankesë e nëpunëses së emëruar, regjistruar me nr. 162 prot., datë 02.03.2017, përmes së cilës kërkohet ndërhyrja jonë në zgjidhjen e kësaj çështje.
- ✓ Është revokuar akti administrativ nr.78, datë 11.02.2016, për emërimin e nëpunësit *****; në pozicionin “*Inspektor në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit, Ushqimi për kafshë me OSH dhe Operatorëve të Biznesit*”, pranë Drejtorisë Rajonale të AKU, Qarku Lezhë. Për këtë pozicion pune janë kryer procedurat e konkurimit dhe fituese është shpallur ***** dhe me aktin nr. 7085, datë 17.11.2016 të DAP është bërë emërimi i saj në pozicionin e sipërm.
- ✓ Nuk është revokuar akti administrativ nr.107, datë 02.03.2016, për emërimin e nëpunësit *****; në pozicionin “*Përgjegjës në Sektorin e Shërbimeve të Brendshme*”, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Dibër. Për këtë pozicion pune janë kryer procedurat e konkurimit nga DAP, shpallja me nr. 1068, mirëpo nga kjo procedurë nuk është shpallur asnjë fitues.
- ✓ Nuk është revokuar akti administrativ nr.72, datë 08.02.2016, për emërimin e nëpunësit *****; në pozicionin “*Përgjegjës në Sektorin e Shërbimeve të Brendshme*”, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Lezhë. Për këtë pozicion pune janë kryer procedurat e konkurimit nga DAP, shpallja me nr. 1067, mirëpo nga kjo procedurë nuk është shpallur asnjë fitues.
- ✓ Është revokuar akti administrativ nr.81, datë 12.02.2016, për emërimin e nëpunësit *****; në pozicionin “*Specialiste në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun dhe Ndërgjegjësimin të Konsumatorit*”, në Drejtorinë e Vlerësimit dhe Komunikimit të Riskut,

pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU. Për këtë pozicion pune janë kryer procedurat e konkurimit nga DAP dhe ka rezultuar fituese ***** e cila me aktin nr.4906 prot., datë 08.08.2016, ka filluar marrëdhëniet e punës. Mirëpo ***** është emëruar pa u zbatuar procedura, me shkresën nr.4305 prot., datë 18.10.2016, si zëvendësuese në pozicionin “Specialist në Sektorin e Kërkimit Shkencor dhe Dokumentacionit” në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU.

- ✓ Nuk është revokuar akti administrativ nr.82, datë 12.02.2016, për emërimin e nëpunësit ***** në pozicionin “Inspektor në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me OJSH dhe Operatorëve të Biznesit”, pranë Drejtorisë Rajonale të AKU, Qarku Tiranë. Pas përfundimit të procedurës së konkurimit për këtë pozicion pune, me shkresën nr. 5848 prot., datë 29.09.2016 të DAP, është emëruar “nëpunës civil në periudhë prove” punonjësi *****. Rezulton se punonjësi ***** përmes shkresës me nr. 4078 prot., datë 07.10.2016, është transferuar në një pozicion tjetër të shërbimit civil “Sektori i Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për kafshë me OJSH dhe Operatorëve të Biznesit, pranë D.R.të AKU Qarku Vlorë pa u zbatuar procedura.
- ✓ Nuk është revokuar akti administrativ nr.88, datë 16.02.2016, për emërimin e nëpunësit ***** në pozicionin “Inspektor në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me OJSH dhe Operatorëve të Biznesit”, pranë Drejtorisë Rajonale të AKU, Qarku Vlorë. Për këtë pozicion pune janë kryer procedurat e konkurimit nga DAP, mirëpo nga kjo procedurë nuk është shpallur asnjë fitues.
- ✓ Është revokuar akti administrativ nr.143, datë 29.03.2016, për emërimin e nëpunësit ***** në pozicionin “Inspektor në Sektorin e Kontrollit në Pikën e Inspektimit Kufitar”, pranë Drejtorisë Rajonale të AKU, Qarku Durrës. Mirëpo marrëdhënia e punës vazhdon pasi me aktin nr. 7420 prot., datë 30.11.2016, të DAP, është shpallur fitues pas kryerjes së procedurave të konkurimit.
- ✓ Nuk është revokuar akti administrativ nr.142, datë 29.03.2016, për emërimin e nëpunësit ***** në pozicionin “Inspektor pranë Sektorit të Inspektimit të Mbrojtjes së Bimëve dhe Inpoteve Bujqësore”, pranë Drejtorisë Rajonale të AKU, Qarku Lezhë. Nga verifikimet e kryera rezulton se për këtë pozicion pune nuk është kryer ndonjë procedurë konkurimi.
- ✓ Është revokuar akti administrativ nr.144, datë 29.03.2016, për emërimin e nëpunësit ***** në pozicionin “Specialist në Sektorin e Shërbimeve Laboratorike”, pranë Drejtorisë Rajonale të AKU, Qarku Tiranë. Me urdhrin nr. 144/2 prot., datë 05.12.2016 janë ndërprerë marrëdhëniet e punës pasi në këtë pozicion pune është emëruar me urdhrin nr. 7090 datë 17.11.2016 të DAP *****.

5. Është zbatuar pjesërisht rekomandimi për publikimin e vendeve vakante. Vendet e lira përgjithësisht ishin përfshirë në planin vjetor të rekrutimit për AKU-në për vitin 2016, provuar kjo me korespondencën elektronike mes institucionit dhe MBZHRAU si dhe DAP. Vendet vakante janë shpallur edhe në web-site e Departamentit të Administratës Publike . Vetëm në një rast nuk është bërë publikimi i vendit të lirë të punës. Bëhet fjalë për pozicionin e punës “*Inspektor pranë Sektorit të Inspektimit të Mbrojtjes së Bimëve dhe Inputeve Bujqësore*”, pranë Drejtorisë Rajonale të AKU, Qarku Lezhë.
6. Është realizuar nga ana e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, detyra e lënë nga Komisioneri, për të mundësuar kryerjen e ciklit të detyrueshëm të trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA), për punonjësit në periudhë prove. U konstatua se të gjithë punonjësit në periudhë prove kishin kryer trajnimin pranë ASPA-s dhe në përfundim të trajnimit mbas nënshtrimit të provimit detyrues kishin rezultuar kalues.
7. Është realizuar pjesërisht nga ana e Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit, përfundimi i procedurës së konfirmimit në fund të periudhës së provës për nëpunësit të cilëve u ka përfunduar periudha e provës. Është realizuar konfirmimi i tyre, por është konstatuar se vendimi për konfirmim nga eprori direkt është marrë pa u ndjekur të gjitha hapat e kërkuara nga ligji, pasi ka mangësi në dokumentacionin detyrues të administruar për këto raste, të cilat po i specifikojmë rast pas rasti si më poshtë:
 - ✓ Është konfirmuar punonjësi *****, por në procedurën e konfirmimit mungon mendimi i nëpunësit më të vjetër, i cili sipas ligjit mbikëqyr nëpunësin gjatë periudhës së provës.
 - ✓ Është konfirmuar punonjësi *****, por në procedurën e konfirmimit mungon vlerësimi i rezultateve në punë si dhe mendimi i nëpunësit më të vjetër, i cili sipas ligjit mbikëqyr nëpunësin gjatë periudhës së provës.
 - ✓ Është konfirmuar punonjësi *****, por në procedurën e konfirmimit ka mangësi pasi mungon nënshkrimi i zyrtarit autorizues në formularin e vlerësimit të rezultateve në punë gjatë periudhës së provës.
 - ✓ Nuk është konfirmuar punonjësi *****, i cili ka përfunduar periudhën e provës. Ky punonjës ka përfunduar trajnimin në ASPA, dhe për të është shprehur pozitivisht nëpunësi më i vjetër i cili e ka mbikëqyrur. Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë gjatë periudhës së provës ka mangësi pasi mungon nënshkrimi i zyrtarit autorizues, si dhe zyrtari raportues ka firmosur edhe për zyrtarin kundërfirmues. Eprori direkt pas plotësimit të formularit të vlerësimit të punës sipas kërkesave të ligjit duhet të nxjerrë aktin e konfirmimit. Kjo procedurë duhet të ishte bërë pasi ka kaluar afati i përcaktuar nga aktet ligjore.

- ✓ Është konfirmuar punonjësi ******, por në procedurën e konfirmimit mungon vlerësimi i rezultateve në punë gjatë periudhës së provës.
- ✓ Nuk është konfirmuar nëpunësja ****** pasi me aktin nr. 2392/1 datë 13.06.2016, janë ndërprerë marrëdhëniet e punës pasi është dorëhequr.
- ✓ Nuk janë konfirmuar nëpunësit ****** dhe ******, pasi nuk e kanë përfunduar periudhën e provës sepse janë emëruar në datën 10.03.2016.

8. Nuk është zbatuar nga ana e Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit, plotësimi i dosjeve të personelit me formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për çdo nëpunës civil. Nga komunikimi me personin e caktuar nga institucioni për të kontaktuar me grupin e punës nëpunësen ******, u vumë në dijeni të faktit se procesi i vlerësimit të rezultateve në punë nuk është përfunduar. Formularët e vlerësimit në punë nuk ishin bërë pjesë e dosjes personale pasi ato nuk ishin plotësuar sipas kërkesave të përcaktuara nga aktet ligjore dhe për këtë arsye janë kthyer për tu plotësuar.

9. Nuk është zbatuar nga ana e Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit, plotësimi i dosjeve të personelit me përshkrimet e pozicioneve të punës për çdo nëpunës.

Sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në vendimin nr. 100, datë 13.09.2016 *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në institucionin Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave”*, konstatohet se ky vendim është zbatuar pjesërisht.

Nga ana e institucionit nuk janë shfuqizuar tërësisht urdhërat e nxjerra në kundërshtim të hapur me ligjin për emërimin e ******, ******, ******, ******, ****** (ndërprerë dhe rimarrë pa procedurë në një pozicion tjetër) ****** (transferuar pa procedurë në një pozicion tjetër), ******, ******. Shfuqizimi i këtyre urdhërave duhet të bëhet nga titullari i institucionit.

Duke qenë se nga titullari i institucionit AKU nuk ka asnjë veprim, referuar nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, të njoftohet organi i tij epror Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, me qëllim që të realizohet shfuqizimi i akteve të paligjshme.

Nuk janë zbatuar detyrat e ngarkuara Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit pasi prej tyre nuk janë marrë masat e nevojshme për hartimin e përshkrimeve të punës për çdo pozicion pjesë e shërbimit civil. Pas hartimit, miratimit, nënshkrimit nga palët, një kopje e këtij akti duhet të ishte bërë pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil dhe më tej një kopje duhet të ishte depozituar pranë Departamentit të Administratës Publike.

Prej tyre, nuk është zbatuar edhe detyra për plotësimin e dosjeve të personelit me formularët e vlerësimit të rezultateve në punë për çdo nëpunës civil. Edhe pse u pretendua se kjo detyrë nuk është zbatuar pasi formularët e vlerësimit në punë nuk ishin plotësuar sipas kërkesave të përcaktuara nga aktet ligjore dhe janë kthyer për tu plotësuar, ky fakt nuk i çliron ato nga përgjegjësia. Prej tyre nuk ishte marrë asnjë masë për të njoftuar personat përgjegjës sipas pikës 5 Kreut III të Vendimit nr. 109, datë 26.2.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar.

Nga ana e Departamentit të Administratës Publike, duhet të ishin marrë masa për plotësimin e pozicioneve të lira të punës pranë AKU. Duke parë rëndësinë e këtij institucioni, pas dështimit të procedurave të konkurrimit, duhet të ishin marrë masa për plotësimin e këtyre vendeve të lira përmes procedurave të transferimit të përkohshëm për nevoja të institucionit ose me emërim nga lista e pritjes së nëpunësve civilë referuar nenit 66/1/5 të ligjit 152/2015, “Për nëpunësin civil”.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; nenin 90, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe 34 të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të nisur me vendimin nr. 1, datë 13.01.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit paralajmërues të Komisionerit nr. 100, datë 13.09.2016 dhe verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative në fushën e administrimit të shërbimit civil të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, të kryera prej datës 20.05.2016 e në vazhdim”.
2. Konstatimin e zbatimit pjesërisht të rekomandimeve të lëna në Vendimin nr. 100, datë 13.09.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në institucionin Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave”.
3. Për vendosjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil duhet të kryen veprimet e mëposhtme:
 - ✓ Të shfuqizohen tërësisht urdhërat e nxjerra në kundërshtim të hapur me ligjin për emërimin e ***** , ***** , ***** , ***** , ***** , ***** .

- ✓ Të shfuqizohet tërësisht urdhëri për emërimin e punonjësës ***** në pozicionin e punës “*Specialist në Sektorin e Kërkimit Shkencor dhe Dokumentacionit*” në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU.
 - ✓ Të shfuqizohet tërësisht urdhëri për transferimin e punonjësit *****. Shfuqizimi i këtyre urdhërave duhet të bëhet nga titullari i institucionit.
 - ✓ Të zbatohet akti i emërimit nr. 750 datë 03.02.2017, i Departamentit të administratës Publike, duke urdhëruar fillimin e marrëdhënieve të punës dhe ato financiare me punonjësën ***** në pozicionin e punës “*Inspektore (Ushqimi) në Sektorin e Koordinimit të Inspektorëve në PIK*”, në Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU.
 - ✓ Të zbatohet akti i emërimit nr. 7621 datë 06.12.2016, i Departamentit të administratës Publike, duke urdhëruar fillimin e marrëdhënieve të punës dhe ato financiare me punonjësën ***** në pozicionin e punës “*Specialist në Sektorin e Sistemit të Informimit të Shpejtë dhe Mbikëqyrjes së Tregut*”, në Drejtorinë e Vlerësimit dhe Komunikimit të Riskut, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU.
4. Për shfuqizimin e akteve të paligjshme dhe zbatimin e akteve të emërimit nr. 750 datë 03.02.2017, dhe nr. 7621, datë 06.12.2016, të Departamentit të Administratës Publike, ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm ***** të cilit i lihet një afat 15 ditë për zbatim. Me kalimin e këtij afati, në rast se nuk janë zbatuar të gjitha detyrat e ngarkuara, referuar nenit 15/2 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, do të aplikohet gjoba pa asnjë paralajmërim në masën 20% të pagës mujore. Në rast të moszbatimit të mëtejshëm të këtij vendimi, do të aplikohet një gjobë tjetër deri në 50 % të pagës mujore.
 5. Në rast se nga titullari i institucionit AKU nuk janë zbatuar detyrat e mësipërme, referuar nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, ngarkohet organi epror Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, të shfuqizojë aktet e mësipërme të konstatuara të paligjshme.
 6. Ngarkohet Njësia e Burimeve Njerëzore të institucionit AKU të marrë masat e nevojshme për mbylljen e procesit të hartimit të përskrimeve të punës për çdo pozicion pjesë e shërbimit civil. Pas hartimit, miratimit, nënshkrimit nga palët, një kopje e këtij akti duhet të bëhet pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil dhe më tej një kopje të depozitohet pranë Departamentit të Administratës Publike.
 7. Ngarkohet Njësia e Burimeve Njerëzore të institucionit AKU të marrë masa për plotësimin e dosjeve të personelit me formularët e vlerësimit të rezultateve në punë për çdo nëpunësi civil. Të merren masa për njoftimin e personave përgjegjës sipas pikës 5

Kreut III të Vendimit nr. 109, datë 26.2.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, për plotësimin e formularëve të vlerësimit të rezultateve në punë për çdo nëpunës civil, sipas kërkesave të ligjit.

8. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike, të marrë masa për plotësimin e pozicioneve të lira të punës pranë AKU. Pas dështimit të procedurave të konkurrimit, të plotësohen vendet e lira të punës përmes procedurave të transferimit të përkohshëm për nevoja të institucionit ose me emërim nga lista e pritjes së nëpunësve civilë referuar nenit 66/1/5 të ligjit 152/2015, “Për nëpunësin civil”, derisa të kryhen procedurat e konkurrimit.
9. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i AKU, Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA